



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 26

Prishtinë, më 24.10.2018, me fillim në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit , salla N-204

PROCESVERBALI

Në mbledhje morën pjesë: Igor Simiq, kryetar i komisionit, Xhelal Sveçla dhe Danush Ademi, zëvendëskryetarë, Kujtim Shala, Fadil Beka, Jasmina Zhivkoviç, Sasha Milosavljeviç, Rasim Selmanaj, Albert Kinolli, Mufera Serbica Shinik, Slobodan Petroviç dhe Veton Berisha, anëtarë.

Munguan: Haxhi Shala, Duda Balje dhe Zoran Mojsiloviç.

Pjesëmarrës tjerë: përfaqësues i OSBE-së- Senad Karaahmetovic; përfaqësues i KDI-së - Bleronë Hoxha; gazetar kallxo.com - Liridona Ademaj; këshilltar i Sekretariatit të KKK-së Zijush Ahmeti dhe Celal Iliaz, Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Personeli për mbështetjen e komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Igor Simiq**, kryetar i komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Raportim i zot. Shyqiri Bytyqi, ministër i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, lidhur me çështjen e regjistrimit të pjesëtarëve të komunitetit shumicë për vendet e rezervuara të studentëve të komunitetit joshumicë dhe vendeve të rezervuara në Qendrën e Studentëve, për vitin akademik 2018/2019;
3. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtura më: 27.07.2018;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-033 për Produkte të Ndërtimit, me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L- 007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L007 për procedurën jokontestimore, me amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;

6. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-008 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/26 për trashëgiminë në Kosovë, me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;**
7. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari e informoi komisionin se Ministri ka lajmëruar që do të vonohet për arsye të angazhimeve të tija, kryetari dha propozim që pika e dytë të shtyhet pasi të jetë prezent Ministrit zot. Shyqiri Bytyqi dhe Fatmir Svishta drejtor i Qendrës Studentore.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan me propozim e dhënë dhe njëzëri miratuan rendin e ditës, me ndryshimin e pikëve të rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 27.7.2018.

Kryetari hodhi në votim procesverbalin dhe pyeti anëtarët e komisionit a kanë ndonjë vërejtje që i njëjti të ndryshohet apo plotësohet.

Mufesa Sërbica Sinik, propozoi të plotësohet një fjali e procesverbalit, si në vijim:

U ndërlihd me rastin, nëse babai përfaqëson komunitetin shqiptar ndërsa nëna komunitetin boshnjak, atëherë djali nuk mundet ti përket komunitetit turk.

Kryetari konstatoi se procesverbali nga mbledhja e mbajtur më 27.7.2018, do të votohet në komision me ndryshimin e propozuar të deputetes, Mufesa Serbica Sinik.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-033 për Produkte të Ndërtimit, me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;

Kryetari paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.06/L-033 për Produkte të Ndërtimit, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit funksional.

Pas shqyrtimit të projektligjit dhe raportit me amendamente të Komisionit funksional, komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Projektligji nr.06/L-033 për Produkte të Ndërtimit dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L- 007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L007 për procedurën jokontestimore, me amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;

Kryetari paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.06/L- 007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L007 për procedurën jokontestimore, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit funksional.

Pasi nuk kishte vërejtje në projektligj dhe raportin me amendamente të Komisionit funksional, komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Projektligji nr.06/L- 007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L007 për procedurën jokontestimore, dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-008 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/26 për trashëgiminë në Kosovë, me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;

Kryetari paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.06/L-008 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/26 për trashëgiminë në Kosovë, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit funksional.

Pasi nuk kishte vërejtje plotësuese në projektligj dhe raportin me amendamente të Komisionit funksional, komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Projektligji nr.06/L-008 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/26 për trashëgiminë në Kosovë dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

6. Raportim i zot. Shyqiri Bytyqi, ministër i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, lidhur me çështjen e regjistrimit të pjesëtarëve të komunitetit shumicë për vendet e rezervuara të studentëve të komunitetit joshumicë dhe vendeve të rezervuara në Qendrën e Studentëve, për vitin akademik 2018/2019;

Kryetari, Igor Simiq, vazhdoi me pikën e radhës së rendit të ditës dhe përshëndeti pjesëmarrjen e Ministrisë dhe Drejtorit të Qendrës Studentore për raportim para Komisionit, me qëllim që të ofrohen informatat e nevojshme zyrtare dhe të dhënat rreth regjistrimit të studentëve nga radha e komunitetit joshumicë, për vendet e rezervuara nëpër Fakultete dhe në Qendrat Studentore, për vitin akademik 2018/19, në pajtim me Ligjin për Arsimin e Lartë.

Njëkohësisht i ftoi anëtarët e komisionit që të marrin fjalën dhe të jenë pjesë e debatit, në formë të pyetjeve dhe sugjerimeve.

Ministri, g. Shyqiri Bytyqi

Duke diskutuar në lidhje me regjistrimin e komuniteteve joshumicë në universitetet shtetërore, si dhe në lidhje me vendet e rezervuara në Qendrën Studentore në Prishtinë, për vitin akademik 2018/2019, ministri e përmendi që për studentët e komunitetit joshumicë janë ndarë gjithsej 845 vende, apo 12% nga numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar në të gjitha universitetet publike dhe se deri tani janë regjistruar 106 kandidatë të komuniteteve joshumicë, të cilët jetojnë dhe punojnë në hapësirat e Republikës së Kosovës. Në vazhdim të fjalës së tij, ministri e përmendi se vendet e mbetura të cilat janë të dedikuara për studentët e komunitetit joshumicë janë të zbrazura dhe asnjë student i komunitetit shumicë nuk do të mund të regjistrohet në ato vende.

Studentëve kandidatë që vijnë nga radhët e komunitetit joshumicë u është vendosur vetëm një kusht, që në testin pranues duhet ta kalojnë kufirin prej 30% me sukses dhe se kjo vlen në të gjithë universitetet publike për këtë vit akademik. Në fund të fjalës së tij, ministri edhe njëherë e përmendi se deri më tani, për sa ai ka informacione nga ana e udhëheqësve të universiteteve publike, asnjë nga kandidatët, apo thënë ndryshe, asnjë nga studentet e komuniteteve joshumicë nuk është ankuar për ndonjë parregullsi në lidhje me regjistrimin.

Si Institucion i Lartë Arsimor, duam që t'i largojmë të gjitha mëdyshjet dhe problemet dhe jemi të gatshëm që ti zgjidhim në koordinim me Juve, për çka edhe ligji na obligon.

Drejtori i Qendrës Studentore në Prishtinë, g. Svishta e përmendi se, sa i përket vendosjes së studentëve nga ana e komuniteteve joshumicë në Qendrën Studentore në Prishtinë, deri më tani nuk e ka pasur asnjë ankesë dhe se tash për tash gjithçka është në rregull.

Pas fjalës hyrëse, Kryetari i ftoi anëtarët e komisionit që të marrin fjalën dhe të jenë pjesë e debatit në formën e pyetjeve dhe sugjerimeve.

Pyetjet dhe sugjerimet

Muferra Sërbića Shinik, ceku se, me qëllim të mbrojtjes së interesave të kandidatëve nga komunitetet joshumicë, duhet të themi se tashmë disa vite po hasim në fenomene dhe vështirësi nëpër fakultetet publike ku vendet e rezervuara për regjistrimin e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë po mbushen nga pjesëtarët e shumicës. Situata është e njëjtë edhe sa i përket fitimit të qëndrimit në Qendrën Studentore.

Në strukturën organizative të Ministrisë së Arsimit, apo në organogramin e saj, Divizioni për Komunitetet Pakicë është tashmë në kuadër të Divizionit për Kategorinë e Personave me Aftësi të Kufizuara, gjë që nuk është në rregull. Këto çështje duhet të zgjidhen dhe po besojmë që me angazhimin Tuaj do të tejkalohen këto probleme dhe mangësi.

Albert Kinolli, në cilësinë e përfaqësuesit të Komunitetit Rom pajtohet me mendimin se duhet të respektohen procedurat dhe kriteret gjatë regjistrimit në vendet e rezervuara për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë në universitetet publike si dhe gjatë regjistrimit për vendet e rezervuara në Qendrën Studentore. Por, duke i pasur parasysh specifikat e studentëve dhe nxënësve nga Komuniteti Rom, ku gjuha e tyre amtare është gjuha Rome dhe duke e pasur parasysh gjendjen në terren, Ne si përfaqësues të popullit të komunitetit tonë, e kemi për detyrë që të reagojmë dhe të kërkojmë futjen e masave pozitive, apo edhe sjelljen e një Udhëzimi Administrativ me të cilin do të vendoseshin dy apo tri pika dhe do tu jepej mundësia që vendet e zbrazura të plotësoheshin edhe në fazën e dytë të regjistrimit, dhe në këtë mënyrë do tu jepej mundësia e trajtimit të njëjtë të komuniteteve joshumicë, me qëllim të mbrojtjes së interesave të kandidatëve.

Veton Berisha, si përfaqësues i Komunitetit Egjiptian e ka cekur si një element shumë të veçantë, implementimin e Udhëzimit Administrativ nga ana e universitetit, me të cilin vendoset dhe garantohet respektimi i kuotës prej 12% për kandidatët nga radhët e komuniteteve joshumicë. Njëjtë ishte sjellë në mandatin e kaluar me vullnet politik dhe institucional dhe procesi i përgjithshëm ishte mbuluar nga Ambasadat dhe Zyra e BE-së. E vërtetë është se jemi përballuar me probleme të caktuara, sidomos në afatin e dytë të regjistrimeve në lidhje me deklarin e kandidatëve dhe fitimin e qëndrimit në Qendrën Studentore.

Për t'u shmangur problemeve të tilla nevojitet një koordinim institucional ndërmjet Neve si ministri dhe Rektoratit si Pushtet Ekzekutiv, me qëllim të ndryshimit të Udhëzimeve dhe gjetjes së zgjidhjes së mirë, pasi që ka hapësirë për keqpërdorime me respektimin e kornizës ligjore të Kosovës.

Danush Ademi, tha se në gjithë këtë proces ekziston dukuria e keqpërdorimit të identitetit dhe ankesa të natyrave të ndryshme, sidomos për Qendrën Studentore. Sipas të dhënave tuaja, ai tha se është një numër i vogël i kandidatëve të regjistruar dhe se një numër i madh i vendeve ka mbetur i zbrazur. Ai e ceku se e mbështetë kolegun Vetonin dhe propozon që edhe njëherë të rishikohet Udhëzimi Administrativ dhe në këtë mënyrë të tejkalohen këto probleme por edhe vetë problematika për të ardhmen, në koordinim me ta.

Xhelal Sveçla, e pyeti ministrin nëse Ministria e Arsimit ka ndonjë program të veçantë për komunitete, përkatësisht Qendër për trajnime pas kryerjes së shkollës së mesme për regjistrimin e kandidatëve në fakultete.

7. Të ndryshme

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Igor Simić